



**Universiteti Shtetëror i Tetovës**  
**Државен Универзитет во Тетово**  
**State University of Tetova**

Republika e Maqedonisë, 1200 Tetovë -Tetovo, Rr.-ul . Ilinden-Ilindenska Rektorati i Universitetit-Rektorat na Univerzitetot

Republic of Macedonia, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) Tel: ++389 44 356 500 Fax: 044 334 222

*Në bazë të nenit 106 të Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në pajtim me Vendimin për organizimin e studimeve pasdiplomike në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Rregulloren për bazat e përbashkëta për organizimin e studimeve pasdiplomike dhe studimeve të doktoraturës në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Drejtoria e Rektoratit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2009, sjell vendim, me të cilin shpall:*

## K O N K U R S

**për regjistrimin dhe transferin e studentëve në studimet pasdiplomike në fakultetet e Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin akademik 2009/2010**

### I.

Fakulteti	Studimet e magistraturës			
	Fusha shkencore	Grada shkencore	Pagesa për semestër	Kohëzgjatja e studimeve
Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore	Matematikë	Magjistër i matematikës	1000	II sem
	Gjeografi	Magjistër i gjeografisë + emri i modulit	1000	II sem
	- Gjeografi regjionale - Gjeografi socio-ekonomike			
	Informatikë	Magjistër i informatikës	1000	II sem
	Biologji	Magjistër i biologjisë + emri i modulit	1000	II sem
	- Botanikë - Zoologji - Biokimi			
	Kimi			
- Kimi organike me biokimi - Kimi analitike me mbrojtje të mjedisit jetësor - Kimi inorganike me kimi fizike	Magjistër i kimisë + emri i modulit	1000	II sem	
Instituti i Ekologjisë dhe Teknologjisë	Ekologji	Magjistër i ekologjisë	1000	II sem
Fakulteti Ekonomik	Ekonomi	Magjistër i ekonomisë + emri i modulit	750	II sem
	- Menaxhment - marketing - Financa, kontabilitet dhe revizion - Biznes-ekonomi			
	- Turizëm	Magjistër i turizmit	750	II sem
Fakulteti Juridik	- E drejta penale - E drejta civile	Magjistër i drejtësisë + emri i modulit	750	II sem
Fakulteti Filozofik	<b>Studime të magistraturës</b>			
	- Filozofi	Magjistër i filozofisë	750	II sem
	- Pedagogji	Magjistër i pedagogjisë	750	II sem
	- Sociologji	Magjistër i sociologjisë + emri i modulit	750	II sem
	- Drejtimi kërkimor-shkencor - Drejtimi arsimor			
	- Histori	Magjistër i historisë + emri i modulit	750	II sem
	- Historia bashkëkohore - Historia e kohës së re - Historia e mesjetës			
	-Psikologji			
- Psikologjia arsimore - Psikologjia industriale - Psikologjia klinike - Drejtimi kërkimor-shkencor	Magjistër i psikologjisë + emri i modulit	750	II sem	

<b>Fakulteti Filologjik</b>	<b>Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>			
	- Gjuhë shqipe	Magjistër i gjuhës shqip	750	II sem
	- Letërsi shqipe	Magjistër i letërsisë shqipe		
	<b>Gjuhë dhe letërsi maqedonase</b>			
	- Gjuhë maqedonase	Magjistër i gjuhës maqedonase	750	II sem
	- Letërsi maqedonase	Magjistër i letërsisë maqedonase		
	<b>Gjuhë dhe letërsi angleze</b>			
	- Gjuhë angleze	Magjistër i gjuhës angleze	750	II sem
	- Letërsi angleze	Magjistër i letërsisë angleze		
	<b>Gjuhë dhe letërsi gjermane</b>			
	- Gjuhë gjermane	Magjistër i gjuhës gjermane	750	II sem
	- Letërsi gjermane	Magjistër i letërsisë gjermane		
<b>Gjuhë dhe letërsi frënge</b>				
- Gjuhë frënge	Magjistër i gjuhës frënge	750	II sem	
- Letërsi frënge	Magjistër i letërsisë frënge			
<b>Fakulteti i Arteve</b>	<b>Arti muzikor</b>			
	- Kompozim	Magjistër i artit muzikor + emri i modulit	1250	II sem
	- Dirigjim orkestral			
	- Muzikologji			
	- Etnomuzikologji			
	- Harmoni me analizë të harmonisë			
	- Polifoni me kompozim polifonik			
	- Forma muzikore me analizë			
	- Metodika e mësimit të muzikës			
	- Metodika e mësimit të pianos			
- Metodika e mësimit të instrumenteve frymore				
- Metodika e mësimit të instrumenteve me harqe				
- Metodika e mësimit të instrumenteve të kësulave				
- Metodika e mësimit të instrumenteve të kësulave				
- Dirigjimi koral				
- Teoria e orkestrimit				
- Solfezhi				
- Flauti				
- Oboa				
- Klarineta				
- Saksofoni				
- Fagoti				
- Buria				
- Hora				
- Tromboni				
- Tuba				
- Solo këndimi				
- Piano				
- Bashkërepeticion				
<b>Arti figurativ</b>				
- Pikturë	Magjistër i artit figurativ + emri i modulit	750	II sem	
- Grafikë				
- Skulpturë				
- Dizajn grafik				
<b>Fakulteti i Kulturës fizike</b>	<b>Kulturë fizike</b>			
- Edukatë fizike dhe shëndetësore	Magjistër i kulturës fizike + emri i modulit	750	II sem	
- Sport				
- Menaxhim i sportit				

## II.

		Studime të magjistraturës		
<b>Fakulteti Ekonomik</b>	<b>Ekonomi</b>			
	- Menaxhment - marketing	Magjistër i ekonomisë + emri i modulit	500	IV sem
	- Financa, kontabilitet dhe revizion			
- Biznes-ekonomi				
<b>Turizëm</b>				
- Menaxhmenti turistik	Magjistër i menaxhmentit turistik	500	IV sem	
<b>Fakulteti Juridik</b>	- Drejtimi gjyqësor	Magjistër i drejtësisë + emri i modulit	500	IV sem
	- Drejtimi administrativ			
	- E drejta ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare			

### III. Kushtet për konkurrim

Të drejtë për konkurrim kanë kandidatët që i plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- Të kenë të kryer studime deridiplomike /cikli i parë i studimeve universitare në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, në studimet përkatëse ose studime deridiplomike të ngjashme;
- T'i plotësojnë kushtet tjera të parapara sipas **Vendimit për organizimin e studimeve pasdiplomike** në fakultetet e Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe Rregullores për bazat e përbashkëta për organizimin e studimeve pasdiplomike dhe studimeve të doktoraturës në Universitetin Shtetëror të Tetovës;
- Kandidatët, sipas pikës II, duhet t'i kenë kryer studimet deridiplomike - **ciklin e parë të studimeve universitare në kohëzgjatje prej 4 vjetësh**, në drejtimin e studimeve përkatëse ose të ngjashme, si dhe kandidatë që kanë kryer studime deridiplomike përkatëse, ose studime të ngjashme 4 vjeçare, sipas kushteve të parapara me Vendimin për organizimin e studimeve deridiplomike në fakultetin përkatës të Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe Rregulloren për bazat e përbashkëta për organizimin e studimeve pasdiplomike dhe të doktoraturës në Universitetin Shtetëror të Tetovës;
- Gjatë regjistrimit në studimet pasdiplomike, kandidatët duhet të dorëzojnë vërtetim për njohje të përgjithshme të më së paku një gjuhe botërore, të lëshuar nga institucioni arsimor kompetent.

Në kushte të barabarta, **përparësi gjatë regjistrimit do të kenë kandidatët me notë më të lartë mesatare** nga suksesi i arritur gjatë studimeve, si dhe kohëzgjatja e përvojës së punës për kandidatët e paraqitur për studime me korrespondencë.

**Programi i studimeve të rregullta u dedikohet studentëve që nuk janë të punësuar dhe kanë mundësi t'i ndjekin rregullisht mësimet. Programi i studimeve të rregullta, sipas pikës I, të studimeve pasdiplomike zgjat një (1) vit dhe paraqet vazhdim të programit të studimeve nga cikli i parë.**

**Programi i studimeve pasdiplomike, sipas pikës II (Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik), zgjat dy (2) vjet, dhe paraqet vazhdim të programit studimor të ciklit të parë. Studentët të cilët kanë të përfunduar studime deridiplomike trevjeçare dhe të cilët duan të përfundojnë studime deridiplomike katërvjeçare kanë mundësi që ta dëgjojnë dhe ti japin provimet e parapara me planë-program vetëm vitin e katërt dhe të paisen me thirrje i diplomuar.**

Programi i studimeve me korrespondencë është i dedikuar për personat e punësuar, për shkak të detyrave të punës, ose për personat, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë mundësi t'i ndjekin mësimet e rregullta. Për shkak të karakterit të studimeve, kohëzgjatja e programit të studimeve me korrespondencë është më i gjatë se i studimeve të rregullta, por nuk duhet të jetë më i gjatë se dy vite akademike.

Kohëzgjatjen e programit të studimeve me korrespondencë e përcakton bartësi i programit studimor të fakultetit përkatës, në varësi të mundësive të studentëve me korrespondencë për ndjekjen e mësimet.

Zgjedhjen e kandidatëve, **me propozim të Drejtorisë së Dekanatit të Fakultetit përkatës, e përcakton Drejtorja e Rektoratit të Universitetit.**

Nëse në konkurs paraqiten më pak se 10 kandidatë, Drejtorja e Rektoratit do të sjell vendim nëse do të organizohet mësim në studimet pasdiplomike në fakultetin përkatës, në vitin akademik në vijim. **Studimet në Fakultetin e arteve, Programi studimor Art muzikor, do të zhvillohen vetëm nëse për një drejtim do të paraqiten 3 kandidatë, në të kundërtën studimet nuk do të realizohen**

- IV. Mjetet e nevojshme financiare sigurohen nga studentët kandidatë, sipas pikës I, të cilët do të regjistrohen në studimet pasdiplomike në USHT, si taksë shkollimi, e cila është në shumë **prej 2000 euro, respektivisht për Fakultetin e Arteve Programi studimor Art muzikor 3000 euro.**

**Taksa e shkollimit paguhet në dy këste.**

**Kësti i parë** për studimet e magjistraturës, në semestrin e parë është **750 euro**, kësti i dytë, në semestrin e dytë është **750 euro** dhe mbrojtja e temës së **magjistraturës 500 euro (shumë e cila paguhet para mbrojtjes së temës).**

Kandidatët që do të regjistrohen në studimet pasdiplomike në Fakultetin e Shkencave Matematikore Natyrore dhe Fakultetin e Arteve të Universitetit, paguajnë taksë shkollimi në lartësi siç vijon:

**Kësti i parë** për studimet e magjistraturës për **Fakultetin e Arteve, Programi studimor Art muzikor**, në semestrin e parë është **1250 euro**, kësti i dytë, në semestrin e dytë është **1250 euro** dhe mbrojtja e temës së **magjistraturës 500 euro (shumë e cila paguhet para mbrojtjes së temës).**

**Kësti i parë** për studimet e magjistraturës në Fakultetin e Shkencave Matematikore Natyrore, në semestrin e parë është **1000 euro**, kësti i dytë, në semestrin e dytë është **1000 euro** dhe mbrojtja e temës së **magjistraturës 500 euro (shumë e cila paguhet para mbrojtjes së temës).**

- V. Studentët kandidatë, sipas pikës II, të cilët regjistrohen në studimet pasdiplomike në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, si taksë shkollimi e cila është në shumë prej 2500 euro.

Kësti i parë për studimet e magjistraturës, në semestrin e parë është në shumë prej 500 euro, kësti i dytë në semestrin e dytë - 500 euro, kësti i tretë në semestrin e tretë - 500 euro, kësti i katërt në semestrin e katërt në shumë prej 500 euro dhe mbrojtja e temës së **magjistraturës 500 euro (shumë e cila paguhet para mbrojtjes së temës).**

**VI. Mësimin në studimet pasdiplomike në Universitetin Shtetëror të Tetovës do ta zhvillojnë mësimdhënës nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti “Shën Qirili dhe Metodi” i Shkupit, si dhe viziting profesorë prej universiteteve me renome nga jashtë, me të cilët Universiteti ka lidhur kontrata bashkëpunimi.**

Mësimi në semestrin e parë të studimeve pasdiplomike do të fillojë më **15 nëntor të vitit 2009 dhe do të zgjasë deri më 15 janar të vitit 2010**, kurse semestri i dytë, nga **15 mars deri më 15 qershor të vitit 2010**.

Kohëzgjatja e mësimin në semestrin e tretë dhe të katërt të studimeve pasdiplomike në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik (tek të cilët studimet zgjasin dy vjet), do të shpallen në mënyrë plotësuese nga fakulteti përkatës i Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Ligjëratat do të mbahen në fakultetet përkatëse të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Aktivitetet tjera në lidhje me mësimin do të zhvillohen me ndihmën e mentorëve, në marrëveshje me studentët sipas planit individual.

## VII. Dokumentet e nevojshme për paraqitje

Paraqitja bëhet në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Rruga e Ilindenit p.n. 1200 Tetovë.

### Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje për regjistrim;
- Diplomë për kryerjen e arsimit sipëror dhe Certifikatë për provimet e dhëna;
- Biografi të shkurtër (CV);
- Vërtetim për njohjen e së paku një gjuhe botërore, të dhënë nga institucioni arsimor adekuat.
- Rekomandime nga profesorë ose punonjës shkencorë (nëse i posedon ato);
- Vërtetim për përvojë në punë dhe për llojin e detyrave të cilat i ka ushtruar gjatë punës, si dhe kërkesë nga organizata e punës - institucioni, për regjistrim të studimeve pasdiplomike;
- Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe kopje nga të njëjtat (nëse kandidatët kanë të tilla);
- Dëshmi për çmime të fituara, mirënjohje dhe të ngjashme, si dhe dokumente të tjera (nëse të tilla janë paraparë me aktet e institucionit përkatës).
- Vërtetim për pagesë të:
  - a. **3000 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit:160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 100000000063095, thirrje në numrin 723019, programi 43, në emër të taksave administrative.

## VIII. Afatet për regjistrim

Fletëparaqitja dhe dokumentet tjera për regjistrim, dorëzohen në fakultetet përkatëse të Universitetit, nga dita e shpalljes së këtij Konkursi.

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2009/10	Afati i I i regjistrimit	Afati i II i regjistrimit	Afati i III i regjistrimit
Paraqitja e kandidatëve	<b>22. qershor deri 07 korrik</b>	<b>01 deri 23 shtator</b>	<b>01. tetor deri 10 nëntor</b>
Shpallja e listës preliminare	<b>08 korrik</b>	<b>24 shtator</b>	<b>11 nëntor</b>
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	<b>10 korrik</b>	<b>26 shtator</b>	<b>13 nëntor</b>
Regjistrimi i kandidatëve	<b>10 deri më 14 korrik</b>	<b>29 -30 shtator</b>	<b>13 deri më 16 nëntor</b>

Drejtorja e Dekanatit shpall listë preliminare për pranim. Pas shpalljes së Listës preliminare kandidatët që kanë konkurruar kanë të drejt ankese në kohë prej 24 orëve nga momenti i shpalljes së listës deri te Drejtorja e Dekanatit i cili e shpall Listën preliminare. Drejtorja e Rektoratit, në fakultetin përkatës shpall Vendim për pranimin e studentëve (listën përfundimtare), në bazë të së cilës kryhet regjistrimi i studentëve.

Gjatë **regjistrimit**, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Tri fotografi ( dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
  - **1200 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 100000000063095, thirrje në numrin 723019, programi 43, në emër të dhënies së Indexit.
  - **pagesa e mjeteve për semestrin e parë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 100000000063095, thirrje në numër 723019, programi 43.

**VIII. Gjatë transferimit (të cilët një pjesë të studimeve pasdiplomike e kanë kryer në ndonjë institucion tjetër të lartë arsimor), kandidatët përpos dokumenteve të sipërpërmendura në pikën VII si shtesë dorëzojnë këto dokumente:**

1. Certifikatë të notave nga fakulteti amë
2. Index
3. vërtetim për pagesën e mjeteve:  
**6000 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit:160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 100000000063095, thirrje në numrin 723019, programi 43, në emër të taksave administrative.

Informata më të hollësishme mund të merren përmes telefonit: **044-356-508, 356-517 ose 356-518.**

**Universiteti Shtetëror i Tetovës**